



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**ADGJTHFR.2/24**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga palët ankuese av. B.Q. dhe av. L.Q.I., që të dy nga Ferizaj, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj A.Sh., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 5 mars 2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, A.Sh., e paraqitur nga palët ankuese av. B.Q. dhe av. L.Q.I., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, (në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent), më 23 shkurt 2024 ka pranuar ankesën e ushtruar nga palët ankuese av. B.Q. dhe av. L.Q.I. ( në tekstin e mëtejme ankuesit) kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj A.Sh.

Ankuesit në ankesën e ushtruar ndaj gjyqtarit A.Sh., kanë theksuar se në seancën gjyqësore penale të evidentuar me numër të lëndës 2021:253489 të mbajtur me datë 16.01.2024, deri sa ishte duke u dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit pala e dëmtuar, deri sa i referohet një prove e cila nuk ishte e

propozuar si prove në aktakuzë për tu lexuar dhe shtjelluar dhe nisur nga fakti se gjyqtari pas paraqitjes së fjalëve hyrës të palëve vetëm se kishte marr aktvendim procedural ku kishte vendosur që në atë çështje penale fillimisht të nxirreshin, lexoheshin dhe administroheshin provat e propozuara në aktakuzë, duke njoftuar palët se për propozime të reja e të cilat nuk janë në aktakuzë mund të bëhen vetëm pas shtjellimit të provave të paraqitura në aktakuzë dhe si mbrojtës i të pandehurit R.R., unë av.B.Q. kam ngritur dorën dhe kam kërkuar që në procesverbal të evidentohet kundërshtimi i mbrojtjes lidhur me proven material, në të cilën ishte duke duke u thirrë pala e dëmtuar, në momentin kur unë si mbrojtës kam paralajmruar gjyqtarin se kemi kundërshtim, pala e dëmtuar nga foltorja i është ofruar gjyqtarit dhe i ka dorëzuar proven material për të cilën gjyqtari mua më është drejtuar “kjo prove paska vulën dhe nënshkrim”, në atë moment kam kërkuar që vetëm të më lejohet evidentimi i kundërshtimit në procesverbal, duke qenë se kundërshtimi im ishte i thjesht dhe i bazuar. Dhe gjyqtari është ngritur në këmbë dhe mbrojtësve i është drejtuar duke provuar që të tregoj autoritete jo kompetente me fjalët: “...Unë kam qenë kryetar i Shtërpcës, kam punuar si gjyqtar edhe në Gjykatën e Shtërpcës, kam pas shumicën e rasteve me sërbë, bile edhe EULEXI më kanë marr me helicopter në raste të caktuar, po ju tregoj se nëse nga tash e tutje unë ju tërheqë vërejtjenju si avokat më nuk mund shkelni me këmbë në gjykatë...”.

Pas kësaj ankuesit kanë theksuar se në atë moment duke qenë se reagimi dhe sjellja e gjyqtarit ishte padyshim në kundërshtim edhe me nenin 5 paragrafi 1 pika 5.1.3, neni 5 paragrafi 2 pika 5.2.1, 5.2.2, 5.2.10 dhe 5.2.15 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe duke nisur faktin se kërcënimi i gjyqtarit ndaj mbrojtësve të të pandehurve me fjalët e cituara më lartë, pasivizonte në tërësi punën e mbrojtësve të të pandehurve në atë çështje, rrjedhimisht sjellja e gjyqtarit, shkelte rëndë parimin e barazisë së palëve në procedure, duke e bërë sjelljen e gjyqtarit të çështjes të ishte edhe në kundërshtim të plotë me paragrafin 2, 3 dhe 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe me nenin 3 paragrafi 2 lidhur me nenin 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykata, dhe si mbrojtës kan deklaruar se kanë zgjedhur që të dalin nga seanca.

Ankuesit kanë kërkuar nga Kryetari i Gjykatës që të kuptoj drejt këtë kërkesë, duke theksuar se nuk ndjejm frik nga gjyqtari, mund të na e ndaloj që si avokatë të hymë në Gjykatën Themelore Ferizaj, ngase edhe ai vet e din që të drejtën për ushtrimin e profesionit të avokatit, nuk na e ka dhënë gjyqtari në fjalë e as nuk do mund të na heqë atë të drejt, sikur se e din se edhe Gjykata Themelore Ferizaj, nuk është prone e gjyqtarit e as biznes i tij privat.

Tutje ka shtuar se është fakt se me kërcënimin e tij të shpjeguar si më lartë, gjyqtari i çështjes, mbrojtësi i ka pamundësuar përfundimisht që në vazhdim të kësaj çështje penale, ta bëjë punën e saj sipas ligjit, ngase ne si mbrojtje me vet faktin që jemi lëshuar në shqyrtim kryesor të asaj çështje penale, e dimë se do ketë kundërshtime nga ana e jonë, sepse nuk e kemi ndërmend të prezantojmë në gjykatë vetëm figurativisht, apo vetëm sa për ti mundësuar gjykatës zhvillimin e procedurës penale, mbi këto arsye duke qenë se gjyqtari A.Sh., hapur në seancën gjyqësore dt. 16.01.2024 ka bërë sjellje dhe komunikime verbale me të cilat ka manifestuar vendosmërinë e tij si gjyqtarë, që kundërshtimet e mbrojtjes në këtë çështje penale të mos i evidentoj në procesverbal, me çka edhe ka pamundësuar barazinë e palëve në procedurë, konsiderojmë se në këtë rast janë plotësuar kushtet ligjore që kjo çështje penale nga gjykata, ti caktohet një gjyqtari tjetër për tu gjykuar, e po ashtu gjyqtari A.Sh. të dërgohet në Komisionin Disiplinor, ne kuptim të nenit 5, 5, paragrafi 1. pika 5.1.3, neni S par. 2 pika 5.2.1 , 5.2.2, 5.2.10 dhe 5.2.15, te Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Lidhur me këtë çështje disiplinore, me datë 27.02.2024, ankuesit përmes parashtresës e kanë njoftuar autoritetin kompetent se heqin dorë nga kërkesa që gjyqtari A.Sh. të dërgohet në komision disiplinor pa dhënë sqarime dhe arsye lidhur me tërheqjen e kërkesës, ndërsa kanë theksuar se ngelin pranë kërkesës që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit në gjykimin e çështjes penale me numër 2021:253489 në kuadër të rrethanave dhe arsyeve të specifikuara si në kërkesën e datës 23.02.2024.<sup>1</sup>

Autoriteti kompetent, bazuar në kërkesën ankuesve të datës 23.02.2024 dhe pretendimeve të tyre në këtë ankesë, por bazuar edhe në parashtresën e datës 27.02.2024, me të cilët ankuesit janë tërhequr nga kërkesa për inicim të procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit A.Sh., edhe përkundër parashtresës mbi tërheqjen e kësaj kërkesë, sipas detyrës zyrtare ka ndërmarrë veprime dhe e ka trajtuar ankesën e ankuesve për ta vërtetuar nëse në veprimet e gjyqtarit ka bazë të arsyeshme për të besuar se kemi të bëjmë me shkelje disiplinore.

---

<sup>1</sup> Lidhur me çështjen e përjashtimit të gjyqtarit të çështjes, Kryetari i Gjykatës do të vendos me aktvendim të veçantë, pasi që me këtë vendim autoriteti kompetent e ka vlerësuar vetëm aspektin e shkeljeve të supozuara disiplinore.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje A.Sh., në deklaratën e tij me shkrim me datë 28.02.2024, ka deklaruar se me datë 13.02.2024 në lëndën penale 2021:253489, kam caktuar shqyrtimin gjyqësor sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Ferizaj, dhe pasi që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me paraqitjen e provave, ku në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor është ftuar i dëmtuari Xh.H, që të dëgjohet në cilësi të dëshmitarit dhe gjykata e kishte udhëzuar sipas dispozitave të KPP-së, i cili gjatë dëshmisë së tij e kishte njoftuar prokurorin e shtetit dhe gjykatën se ka si dëshmi edhe raportet nga organi relevant i ndërtimit, dhe kur gjykata i kërkon për ta shikuar këtë provë, por pa pritur dhe pa lejen e gjykatës ka ndërhyrje nga mbrojtësja e të akuzuarit N.B., av. L.Q.I., e cila e njofton gjykatën se i dëmtuari ka telefon me veti, ku unë si gjyqtar nuk kam parë e as dëgjuar që i dëmtuari ka telefon dhe nuk kam vërejtur se i njëjti të ketë hapur telefonin gjatë seancës, por kam ndërprerë seancën dhe kam kërkuar nga Policia e Kosovës e cila ishte prezent në sallë që telefonin ta largoj ku i dëmtuari i ka dorëzuar policisë.

Gjyqtari ka theksuar në deklaratën e tij, se i ka njoftuar avokatët se përveç provave të propozuara nga palët gjykata ka të drejtë të siguroj provën që konsideron të nevojshme për verifikim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, duke ja tërhequr vërejtjen avokatëve që të përmbahen rregullave të kodit të etikës, duke theksuar se i ka njoftuar se ka një provoj të gjatë që ka punuar në Komunën e Shtërpçës para dhe pas lufte si nënkryetar komune por edhe si Gjyqtar mbikëqyrës i Gjykatës Themelore Ferizaj -Degës në Shtërpçë, gjithherë kam pasur bashkëpunim të mirë me të gjitha Institucionet vendore dhe ndërkombëtare, e në veçanti me KFOR-in Amerikan, OSBE-në, por deri metani asnjëherë ju garantoj se askujt nuk i kam dhënë vërejtje në profesionin e tyre qoftë me gojë apo me shkrim, andaj kërkoj që të vazhdohet me dëgjimin e dëshmitarit dhe në fund ti shikojmë propozimet e tija, por të dy avokatët e mbrojtësve edhe përkundër njoftimit ngritën dhe pa i respektuar rregullat procedurale kërkojnë që të ndërpritet vazhdimi i seancës gjyqësore dhe kërkojnë që të përjashtohem si gjyqtarë gjykues dhe të njëjtit janë larguar nga salla e gjyqimit dhe unë si gjyqtar me aktvendim kam ndërprerë seancën gjyqësore pasi që mbrojtësit kanë kërkuar që unë si gjyqtar i çështjes të përjashtohem.

Gjyqtari A.Sh., në deklaratën e tij ka shtuar se, nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesve të cekura në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore, se unë si gjyqtar gjykues tu kem thënë mbrojtësve se: *“nëse nga tash e tutje unë i'u tërhiqi vërejtje juve si avokat, më nuk mund të shkelni me këmbë në këtë gjykatë...”*, e po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet se gjatë mbajtjes së këtij shqyrtimit

mbrojtësve të ju është shkelur barazia e palëve as që ju ka bërë kufizim në deklaratimet e tyre, ku si provë për këtë është procesverbali i seancës gjyqësore.

Gjyqtari gjithashtu ka theksuar se të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në këtë lëndën Penale, P.nr.2021:253489, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësi si gjyqtar, deri në këtë fazë të procedurës penale nga pranimi i kësaj lënde deri me datë 13 shkurt 2024, së pari në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave të lëndës, ka arritur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari A.Sh.

Kryetari i Gjykatës vlerëson se pretendimet e palës ankuese, se gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor në rastin e dëgjimit të dëshmitarit Xh.H., nuk i është lejuar kundërshtimi lidhur me provën materiale në të cilën ishte thirrur i dëmtuari, pas shikimit të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 13.02.2024, në faqe 9 është konstatuar vetëm deklarimi i av. L.Q.I., e cila e ka njoftuar gjyqtarin se i dëmtuari “*ka telefon me vete*” dhe gjithashtu janë konstatuar vërejtjet e gjyqtarit në drejtim të avokatëve mbrojtës, që ti përmbahen rregullave të kodit të etikës, dhe jo ndonjë vërejtje tjetër në formën “*kërcënuese se ...si avokat, më nuk mund të shkelni me këmbë në këtë gjykatë...*” siç është theksuar në kërkesën e ankuesve. Po ashtu në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor nuk kemi ndonjë konstatim apo aktvendim mbi refuzimin e ndonjë propozimi të palëve në procedurë. E gjithashtu nuk kemi të konstatuar ndonjë kërkesë të palëve për korrigjim apo ndonjë koment mbi përmbajtjen e procesverbalit, pasi që palët kanë të drejtë ta kontrollojnë procesverbalin e përfunduar dhe pjesët shtojcë, të bëjnë komente mbi përmbajtjen dhe të kërkojnë korrigjimin e tij, apo të kërkojnë të shënohet edhe pyetja ose përgjigjeja e refuzuar si e palejueshme.

Nga të gjitha këto, vlerësohet se çdo mos lejim i paraqitjes së kundërshtimeve gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor nuk do të thotë apriori pabarazi e palëve dhe trajtim jo i barabartë i palëve në procedurë, dhe nuk mund të themi se është pamundësuar kjo e drejtë mbrojtjes nga ana e gjykatës përkatësisht gjyqtarit në rastin konkret.

Për më tepër theksimet ankimore në ankuesve në kërkesë për inicim të procedurës disiplinore se gjatë shqyrtimit gjyqësor gjatë fazës së dëgjimit në cilësi të dëshmitarit- i dëmtuari i është referuar provës materiale e cila nuk ishte propozuar si provë me aktakuzë dhe gjyqtari e ka lejuar, e cila provë sipas ankuesit është nxjerrë me kërkesën e palës dhe jo siç kërkohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, dhe se mundësia e kundërshtimit të asaj prove nuk i është lejuar nga gjykata, janë të tilla e që kanë të bëjnë lidhur me zbatimin e dispozitave të procedurës penale gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjyqtarit, andaj edhe janë jashtë sferës së autoritetit kompetent për ti trajtuar dhe vlerësuar, dhe se shkeljet e tilla eventuale nuk mund të konsiderohen si shkelje disiplinore, megjithatë të njëjtat pretendime për çfarëdo shkelje të zbatimit të procedurës së shqyrtimit gjyqësor, mund të jenë shkak apo arsye për ushtrimin e mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike në gjykatat me të larta nga cilado palë e pakënaqur në procedurë.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, si dhe bazuar në të dhënat e përshkruara si më lartë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillim të hetimeve disiplinore.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**ADGJTHFR.2/24, datë 5 mars 2024**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

***Iu dërgohet:***

*Av. B.Q. dhe Av. L.Q.I. - Parashtrues i ankesës*

*A.Sh. - Gjyqtar*

*Këshillit Gjyqësor të Kosovës*